



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.60, datë 29.10.2007

**“MBI
KRIJIMIN E SPORTELEVE TE QENDRES
KOMBETARE TE RREGJISTRIMIT (Q.K.R) PRANE BASHKISE TIRANE DHE
MIRATIMIN E KLASIFIKIMIT TE PAGAVE TE PUNONJESVE TE KESAJ QENDRE“**

Në mbështetje të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombetare të Rregjistrimit”, të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32/ç, të Ligjit 8487, datë 13.05.1999 “ Per kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të Ligjit 8935, datë 12.09.2002, “Per disa ndryshime në Ligjin 8487, datë 13.05.1999, “Per kompetencat për caktimin e pagave të punës”, neni 6, gërmat “a”, germa “b”, dhe germa “c”, të Ligjit 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i Nepunesit Civil”, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 434, datë 13.07.2007, “Per disa ndryshime në Vendimin Nr. 551, datë 07.11.2002 të Keshillit të Ministrave, “Per klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjesve të organeve të qeverisjes vendore”, Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë prej 4 (kater) punonjesh në strukturën organizative të Bashkisë së Tiranës (Aparati I Bashkisë), sipas organigramës bashkelidhur.
2. Të miratojë klasifikimin e pagave për këta kater punonjës, sipas lidhjes Nr. 11, pjesë përberëse e këtij vendimi.
3. Efektet financiare do të mbulohen nga fondet e akorduara nga Pushteti Qendror dhe buxheti I miratuar për aparatën e Bashkisë, në vitin 2007.
4. Ky vendim, për vitin 2007, I shtrin efektet financiare për periudhën Nëntor-Dhjetor.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerezore, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Dhenies se Lejeve per Ushtrim Aktiviteti si edhe Drejtoria e Finances.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R